

RAPORT I KOMISIONIT RECENSUES PËR ZGJEDHJE - RIZGJEDHJE TË MESIMDHËNËSVE NË TË GJITHA THIRRJET MESIMORE - SHKENCORE NË UNIVERSITETIN E TETOVËS

Me propozim-vendim të Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Tetovës nr. 14-642/3 të datës, 28.09.2020 dhe në bazë të konkursit të shpallur me: 06.10.2020 në gazetata ditore “Lajm” dhe “Nova Makedonija”. Këshilli mësimor-shkencor i Fakultetit Ekonomik në mbledhjen e mbajtur me datë 21.10.2020, solli vendim me nr. 14-847/9, për caktim të komisionit recensues për zgjedhjen e një mësimdhënësi në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorit në Fakultetin Ekonomik në Universitetin e Tetovës, për lëndët: **Bazat e financave, Financa ndërkombëtare dhe Tregjet dhe institucionet financiare** (në programet studimore: Ekonomi dhe biznes, Financa dhe kontabilitet, Marketing dhe menaxhment, Biznes ndërkombëtar dhe Turizëm), në përbërje:

1. Prof. Dr. Etem Iseni - kryetar
2. Prof. Dr. Ibish Mazreku - anëtar dhe
3. Doc. Dr. Gjilnaipe Bexheti - anëtar

Pas pranimit të dokumentacionit të dorëzuar në konkurs, komisioni në fjalë konstatoi se kanë aplikuar tre kandidatë:

1. Dr. Vjollca Hasani-Limani
2. Dr. Shiret Elezi
3. Dr. Arben Halili

R E C E N Z I O N

Me datë 06.10.2020 në gazetata “Lajm” dhe “Nova Makedonija” është shpallur konkurs për zgjedhjen e një mësimdhënësi në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorit në Fakultetin Ekonomik në Universitetin e Tetovës për lëndët: **Bazat e financave, Financa ndërkombëtare dhe Tregjet dhe institucionet financiare** (në programet studimore: Ekonomi dhe biznes, Financa dhe kontabilitet, Marketing dhe menaxhment, Biznes ndërkombëtar dhe Turizëm).

Komisioni ka shqyrtuar dokumentacionin e kandidatëve dhe paraqet referatin si vijon:

1. Kandidatja Dr. Vjollca Hasani-Limani

I. TË DHËNA BIOGRAFIKE DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL

Kandidatja Dr. Vjollca Hasani Limani ka lindur më 04.08.1988 në Tetovë. Shkollimin fillor e ka kryer në shkollën “Eqrem Çabej” në fshatin Sllatinë, ndërsa shkollën e mesme në SH.M.SH. Ekonomike “8 Shtatori” në Tetovë. Në vitin 2007/08 u regjistrua në Fakultetin Ekonomik në Universitetin e Tetovës, ndërsa në vitin 2010 i mbaron studimet me notë mesatare 9.76 dhe merr titullin Ekonomist i Diplomuar, drejtimi Financa dhe Kontabilitet. Pas përfundimit të studimeve universitare të ekonomisë, kandidatja në tetor të vitit 2010, vazhdon studimet e Magjistraturës në Fakultetin e Ekonomisë dhe Biznesit në Universitetin e Europës Jug-Lindore në Tetovë, në drejtimin Financa. Më 08.10.2013, e mbrojti me sukses temën e magjistraturës me titull “**Mikrofinancimi, financimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme – Rasti i Maqedonisë**” dhe me notë mesatare 8.5 morri titullin **Magjistër i financave**. Pas kryerjes së ciklit të dytë të studimeve (magjistraturës), në vitin 2015 kandidatja regjistron studimet e

Doktoratës në Fakultetin e Ekonomik në Universitetin e Tetovës, drejtimi Financa. Në datë 04 shtator 2020 mbron me sukses të lartë disertacionin e doktoratës me titull **“Roli i mikrofinancimit dhe zhvillimit të NMVM-ve në uljen e varfërisë në Maqedoni”** dhe merr titullin shkencor **Doktor i Shkencave Ekonomike, Drejtimi Financa.**

Kandidatja Dr. Vjollca Hasani-Limani në shtator të vitit 2014 ka filluar punën në Departamentin e Financës, në pozitën e prokurimeve publike në Universitetin e Tetovës. Njëkohësisht është angazhuar si asistente me kohë të pjesshme në Fakultetin Ekonomik. Gjatë asaj periudhe e ka inicuar dhe ka punuar për themelimin e Qendrës për marrëdhënie dhe ndërlidhje me bizneset, ndërsa në janar të vitit 2015 është emëruar udhëheqëse e Qendrës për marrëdhënie dhe ndërlidhje me bizneset në Universitetin e Tetovës.

Në 23 maj të vitit 2018 është zgjedhur në thirrjen asistente-doktorante në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tetovës. Gjatë kësaj periudhe (2014-2020), kandidatja Vjollca Hasani-Limani ka mbajtur mësim (ushtrime) në këto lëndë: Mikroekonomia I; Kontrolli; Revizioni; Bazat e financave; Analiza e raporteve financiare; Hyrje në kontabilitet; Kontabiliteti në turizëm; Financat e korporatave; Financa ndërkombëtare; Menaxhimi Financiar; Bankat dhe punët bankare dhe Tregjet dhe institucionet financiare.

Kandidatja Dr. Vjollca Hasani-Limani, i ka dorëzuar këto dokumente: Diplomën për fitimin e gradës shkencore Doktor i shkencave ekonomike drejtimi financa; Diplomën e ciklit të dytë; certifikatën e notave të ciklit të dytë; Diplomën e ciklit të parë, certifikatën e notave të ciklit të parë; Biografinë e shkurtër; Punimin e doktoraturës; Listën e punimeve shkencore të publikuara si dhe kopje të punimeve; Listën e angazhimeve mësimore; Vërtetim për njohje të gjuhës angleze, niveli B2; Certifikatë të nënshpërndarjes dhe Certifikatë të lindjes.

II. VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE

Veprimtaria mësimore- arsimore e kandidatë Dr. Vjollca Hasani-Limani përbëhet nga angazhime të shumta në vend dhe jashtë vendit si profesor vizitues (visiting profesor).

Kandidatja Dr. Vjollca Hasani-Limani, në kuadër të angazhimit si asistent në Fakultetin Ekonomik, ka mbajtur mësim në këto lëndë: Mikroekonomia I; Kontrolli; Revizioni; Bazat e financave; Analiza e raporteve financiare; Hyrje në kontabilitet; Kontabiliteti në turizëm; Financat e korporatave; Financa ndërkombëtare; Menaxhimi Financiar; Bankat dhe punët bankare dhe Tregjet dhe institucionet financiare.

Në kuadër të Programit për mobilitet të stafit akademik nëpërmjet Erasmus+, kandidatja ka realizuar ligjëratat me temë “Valuation of bonds and stocks” për studentët e ciklit të parë dhe të dytë në Universitetin e Trakias në Edirne, Turqi, në periudhën kohore 24-29.09.2018.

Në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën e zgjedhjes në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe bashkëpunëtor në Universitetin e Tetovës (Buletini i Universitetit), kandidatja Dr. Vjollca Hasani-Limani ka realizuar gjithsej 90.28 pikë nga veprimtaria mësimore arsimore.

III. VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE

Krahas angazhimit në procesin mësimor, kandidatja është angazhuar në hulumtime shkencore në lëmin e shkencave ekonomike. Veprimtaria shkencore-hulumtuese e kandidatës përbëhet nga artikujt shkencorë të botuar në revista shkencore ndërkombëtare, me pjesëmarrje në tubime shkencore ndërkombëtare dhe pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare. Kjo veprimtari e kandidatës është paraqitur më poshtë.

III.1 Punimet e publikuara dhe pjesëmarrja në konferenca

Pjesëmarrje në konferenca shkencore ndërkombëtare dhe punime të publikuara:

1. "Environment Factors, Challenges for Economic Development" në Universitetin e Tetovës në vitin 2015.
2. "International Conference on Research in Education and Science" (ICRES 2016), Bodrum, Turqi
3. Konferencë ndërkombëtare e organizuar nga EVN Macedonia, "Women in Energy" WIN 2017. Shkup.
4. "Challenges of Doing Business in the Contemporary World", në Universitetin e Tetovës. 2017.
5. "Economic development as a precondition for EU intergration". Universiteti i Tetovës. 2018.
6. "Contemporary economic trends" Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Tetovës. 2019.
7. Ka publikuar punimin "The impact of macroeconomic factors on the yield of loan portfolio of microfinance institutions in Macedonia" në European Journal of Business and Management. Vol. 10. No.12. Viti 2018.
8. Ka publikuar punimin "Does microcredit affect poverty reduction in Macedonia" në International Journal of Scientific and Research Publications. Vol. 8. No. 9. Viti 2018.
9. Ka botuar punimin me temë: "Microfinance, the role of credit in the development on small and medium enterprises in Macedonia" në Revistën shkencore me titull "Economic Vision", të Fakultetit Ekonomik. Vol.4. No.7-8. ISSN 1857-9566. Viti 2017.
10. Ka botuar punimin me temë: "Financing of small and medium enterprises – case of Macedonia", në librin e punimeve të International Conference on Research in Education and Science. ISBN 978-605-66950-2-5. Viti 2016.

Në kuadër të përgatitjeve për sferën akademike në pjesën shkencore dhe hulumtuese, në periudhën 2017-2018, kandidatja ka ndjekur trajnimet e Elsevier Research Academy, për "Writing for research" & "Publication process" dhe ka fituar certifikatat si vijon:

1. Certificate of Excellence "Fundamentals of manuscript preparation". 12.06.2018;
2. Certificate of completion "Using proper manuscript language". 14.06.2018;
3. Certificate of completion "Structuring your article correctly" 12.06.2018;
4. Certificate of completion "How to prepare your manuscript" 12.06.2018;
5. Certificate of completion "How to write an abstract and improve your article". 12.06.2018;
6. Certificate of completion "How to review an article". 18.05.2017;
7. Certificate of completion "The journal publishing cycle". 18.05.2017.

Në bazë të shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, komisioni recensues e konstatoi veprimtarinë shkencore-hulumtuese në periudhën paraprake, e cila është e rëndësishme thelbësore për vlerësimin e kandidatit për veprimtarinë shkencore-hulumtuese.

Në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorit në Universitetin e Tetovës (Buletini i Universitetit), kandidatja Dr. Vjollca Hasani-Limani ka realizuar gjithsej 43 pikë nga veprimtaria shkencore-hulumtuese.

IV. VEPRIMTARIA E APLIKUAR PROFESIONALE

Kandidatja Dr. Vjollca Hasani-Limani gjatë periudhës së angazhimeve në aspektin profesional, ka arritur të realizojë një sërë aktiviteteve, të cilat janë shënuar më poshtë:

- Anëtare e Klubit të hulumtuesve të Bankës popullore të Maqedonisë së Veriut nga viti 2019.
- Ideatore dhe organizatore e Panairit të Biznesit në Universitetin e Tetovës. Viti 2019.

- Përpilim i propozim-planit për hapjen e Parkut Teknologjik/Akseleratorit të Biznesit në kuadër të Universitetit të Tetovës të cilin e ka dorëzuar tek udhëheqësia e Universitetit në vitin 2016 si dhe propozim-planin e reviduar dhe avancuar në vitin 2017.
- Pjesë e grupit anketues të kompanive të Maqedonisë, në kuadër të procesit të ri-akreditimit të programeve studimore, me qëllim të vlerësimit të nevojave të tregut të punës. Viti 2019.
- Promovimi i Universiteti të Tetovës në vitet 2015-2019.
- Përpilimi i buxhetit të projektit “Innovative tool for fast and efficient building construction” të kompanisë GEN Holding. 2015.
- Gjetja e sponsorëve për konferencat e Universitetit të Tetovës. Përgatitje e kontratave për sponsorimet dhe koordinim i procesit të pranimit të sponsorimit dhe ndarjen e certifikatave për sponsorim, për kompanitë dhe institucionet sponsoruese. Viti 2016-2019.
- Përgatitje e memorandumëve të bashkëpunimit të Universitetit të Tetovës me kompani dhe institucione. Viti 2015-2020.
- Organizatore e panairit “Food Expo” 2017 dhe 2018 në bashkëpunim me Fakultetin e Teknologjisë ushqimore.
- Pjesëmarrëse në Twinning project “Developing cooperation between higher education institutions, the private sector and relevant bodies” MK 13 IPA SO 01 16 R, viti 2017.
- Udhëheqëse e Qendrës për marrëdhënie dhe ndërlidhje me bizneset nga viti 2015.
- Iniciativa dhe përpilimi i projekt propozimit për hapjen e Qendrës për ndërlidhje me bizneset në Universitetin e Tetovës. Viti 2014.

Në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorit në Universitetin e Tetovës (Buletini i Universitetit), kandidatja Dr. Vjollca Hasani-Limani ka realizuar gjithsej 39 pikë nga veprimtaria e aplikuar profesionale.

V. VEPRIMTARIA ME INTERES MË TË GJERË

Kandidatja Dr. Vjollca Hasani-Limani në tetor të vitit 2014, me anë të projekt-propozimit të dorëzuar në udhëheqësinë e Universitetit të Tetovës, ka inicuar hapjen e një zyre për bashkëpunim me bizneset në kuadër të Universitetit. Pas miratimit të projekt propozimit, me vendim të Rektorit, me nr.02-159/1 në datën 21.01.2015 është emëruar udhëheqëse e Qendrës për marrëdhënie dhe ndërlidhje me bizneset në kuadër të Universitetit të Tetovës. Në kuadër të saj ka inicuar dhe realizuar disa projekte dhe aktivitete:

- Ka përpiluar projekte për inovacion në bashkëpunim me kompanitë dhe ka ndihmuar në aplikimet për grante për bizneset, me të cilët kanë pasur bashkëpunim institucional.
- Ka përgatitur memorandumë bashkëpunimi me biznese, banka, organizata të lidhura me komunitetin biznesor, si dhe ka udhëhequr procedurat formale të bashkëpunimit.
- Ka realizuar takime me odat e biznesit dhe kompanitë e ndryshme.
- Ka koordinuar realizimin e punës praktike të studentëve të Universitetit nëpër kompanitë vendore dhe ndërkombëtare.
- Ka udhëhequr komunikimet zyrtare në mes kompanive dhe Universitetit të Tetovës.
- Ka qenë pjesë e protokollit të organizimit të ngjarjeve të Universitetit të Tetovës.
- Ka qenë pjesë e këshillit organizativ në organizimin e përvjetorit të Universitetit të Tetovës në vitet 2017 dhe 2018. Pjesë e këshillit organizativ të apsolvendiadës 2018.

Në kuadër të aktiviteteve me interes të gjerë, kandidatja ka marrë pjesë edhe në aktivitetet si vijon:

- Pjesëmarrëse (e deleguar nga Universiteti i Tetovës) në seminarin e organizuar nga Ministria e Arsimit në kuadër të projektit të binjakëzimit në fushën e "Zhvillimit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë, sektorit privat dhe organeve përkatëse".
- Pjesëmarrëse (e deleguar nga Universiteti i Tetovës) në punëtorinë e organizuar nga Iniciativa Qendrore Evropiane (CEI) dhe Ministria e Punëve të Jashtme në Maqedoni në temën "Access to Financial Grants for Macedonian Companies" dhe "Promotion of Regional Cooperation for Improving Market Competitiveness of Agricultural and Food Business".
- Pjesëmarrëse (e deleguar nga Universiteti i Tetovës) në punëtorinë e organizuar nga Ministria e Vetëqeverisjes Lokale, Maqedoni në "Preparing project proposals in the frame of the IPA Cross-border Cooperation Program, Kosovo - the former Yugoslav Republic of Macedonia 2014-2020.
- Pjesëmarrëse (e deleguar nga Universiteti i Tetovës) në punëtorinë e projekteve: Horizon 2020, COSME dhe COST, i cili u organizua nga Komisioni Evropian në Maqedoni. Tema: "Preparation of proposal projects and procedures for application for grants"
- Pjesëmarrëse (e deleguar nga Universiteti i Tetovës) në punëtorinë "Management of innovation in Macedonia" organizuar nga Knowledge Center Maqedoni dhe Brain Plus Austri.
- Pjesë e grupit të punës (e deleguar nga Universiteti i Tetovës), në bashkëpunim me Qendrën për Zhvillimin Planor të Rajonit të Pollogut, për formulimin e "Konceptit për Zhvillimin e Strategjive të Inovacionit në Maqedoninë Veri-Perëndimore".
- Pjesëmarrës në projektin "Qëndrueshmëria financiare e OJQ-ve përmes bashkëpunimit me bizneset" në bashkëpunim me Fondacionin Albiz.

Në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorit në Universitetin e Tetovës (Buletini i Universitetit), kandidatja Dr. Vjollca Hasani-Limani ka realizuar gjithsej 10 pikë nga veprimtaritë me interes më të gjerë.

VI. FORMULARI PËR RAPORTIN PËR ZGJEDHJE NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE

Në shtojcë e bashkëngjisim formularin për raportin e zgjedhjes në thirrjen mësimore-shkencore. Kandidatja Dr. Vjollca Hasani - Limani ka gjithsej 182.28 pikë, edhe atë për: veprimtarinë mësimore-arsimore – 90.28 pikë, veprimtarinë shkencore-hulumtuese – 43 pikë, veprimtarinë e aplikuar profesionale - 39 pikë dhe veprimtaritë me interes më të gjerë – 10 pikë.

REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJE	PIKËT
VEPRIMTARIA MËSIMORE-SHKENCORE	90.28
VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE	43
VEPRIMTARIA E APLIKUAR PROFESIONALE	39
VEPRIMTARITË ME INTERES MË TË GJERË	10
TOTALI	182.28

2. Kandidatja Dr. Shiret Elezi

I. TË DHËNA BIOGRAFIKE DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL

Kandidatja Dr. Shiret Elezi ka lindur më 20.03.1981 në Frankfurt. Shkollimin fillor e ka kryer në Offenbah të Gjermanisë, ndërsa shkollën e mesme, gjimnaz në shkollën “Pançe Popovski” në Gostivar. Në vitin 2000 u regjistrua në Fakultetin Ekonomik në Universitetin e Tetovës, ndërsa në vitin 2004, si studente e dalluar i mbaron studimet dhe merr titullin Ekonomist i Diplomuar. Pas përfundimit të studimeve universitare të ekonomisë, kandidatja në vitin 2009 morri titullin **Magjistër i shkencave ekonomike** në Fakultetin Ekonomik të Universitetit “Kirili dhe Metodij” në Shkup. Në vitin 2012, në Fakultetin Ekonomik të Universitetit “Kirili dhe Metodij” në Shkup, mbron me sukses të lartë disertacionin e doktoratës me titull **“Управување на општинските финансии во Република Македонија”** dhe merr titullin shkencor **Doktor i Shkencave Ekonomike**.

Kandidatja Dr. Shiret Elezi në vitin 2005 ka filluar punën si udhëheqëse në sektorin e financës në komunën e Gostivarit, deri në vitin 2016.

Në 5 prill të vitit 2016 deri 30 maj të vitit 2017 ka kryer funksionin e ministres në Ministrinë e pushtetit lokal. Nga 22 qershor 2017 deri në 23 shtator 2020 ka kryer funksionin e zëvendës ministres në Ministrinë e financave. Kandidatja po ashtu është anëtare e NALAS - Network of Associations of Local Authorities; Anëtare e bordit drejtues të rrjetit të punëtorëve financiar ZELS; Anëtare e grupeve punuese për forume buxhetore në komunën e Gostivarit; Anëtare në Komitetin Twinning i përkrahur nga qeveria e Holandës për rritjen e kapaciteteve financiare PIFS, për qendrat lokale në R.M.; Anëtare në grupet punuese në ZELS në sferën e ndryshimeve të taksave dhe tatimeve.

Kandidatja Dr. Shiret Elezi, i ka dorëzuar këto dokumente: Diplomën për fitimin e gradës shkencore Doktor i shkencave ekonomike; Biografinë e shkurtër; Punimin e doktoraturës; Listën e punimeve shkencore të publikuara si dhe kopje të forta të katër punimeve; Kopje të Vendimit për zgjedhjen në thirrjen mësimore shkencore docent, në Universitetin Ndërkombëtar të Strugës; Vërtetim për njohje të gjuhës angleze, niveli B2; Certifikatë të nënshtetësisë dhe Certifikatë të lindjes.

II. VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE

Veprimtaria mësimore - arsimore e kandidatë Dr. Shiret Elezi përbëhet nga angazhime të shumta. Kandidatja ka qenë e angazhuar si bashkëpunëtoje jo e rregullt në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tetovës, në vitin 2012 në lëndët: Financa publike; Tregjet dhe institucionet financiare; Bazat e menaxhmentit dhe Sistemet ekonomike bashkëkohore.

Nga vitin 2014, me vendim nr. 08-162/2 ka fituar thirrjen mësimore shkencore “docent” në grupë lëndësh të shkencave ekonomike në Universitetin Ndërkombëtar të Strugës.

Në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën e zgjedhjes në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe bashkëpunëtor në Universitetin e Tetovës (Buletini i Universitetit), Komisioni recensues konstaton se kandidatja Dr. Shiret Elezi nuk ka dorëzuar dëshmi, për aktivitetet mësimore-arsimore.

III. VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE

Në biografinë e saj, kandidatja ka theksuar se është angazhuar në hulumtime shkencore në lëmi të ndryshme. Kjo veprimtari e kandidatës është paraqitur si vijon:

III.1 Punimet e publikuara dhe pjesëmarrja në konferenca

Publikime shkencore vendore dhe ndërkombëtare:

1. Ka botuar artikullin me temë: “Economic Benefits of joining NATO – The case of new member states and potential impact on sustainable development in Macedonia”, në International Journal of Scientific Engineering and Research (IJSER). Vol. 7 issue 2. ISSN: 2347-3878. Viti 2019.
2. Ka publikuar punimin “Property Tax in transition countries: The case of the Republic Macedonia from 2006-2015” në European Scientific Journal. Vol. 12. Viti 2016.
3. Ka publikuar punimin “Local governance in an international comparative perspective comparing local government finances in Macedonia with Slovenia” në European Scientific Journal. Vol. 11. Publikuar më 30.05.2015.
4. Ka publikuar punimin “Current State of local finances in the Republic of Macedonia” në Economic Development. Nr. 2. Shkup. Viti 2012.
5. Ka botuar librin “Управување на општинските финансии во Република Македонија”. ISBN 978-608-236-027-0. Arberia Design, Shkup 2014.
6. Ko-autor në raportin e NALAS, si përfaqësuese e Asociacionit të komunave të Maqedonisë, në temën “Fiscal decentralization indicators in South East Europe: report 2013” gjendet në Network of Associations of Local Authorities. Shkup. Edicioni 4. Janar 2015.
7. Ko-autor në raportin e NALAS, si përfaqësuese e Asociacionit të komunave të Maqedonisë në temën “Fiscal decentralization indicators in South East Europe: report 2012”, gjendet në Network of Associations of Local Authorities. Shkup. Edicioni 3. Prill 2014.
8. Ko-autor në raportin e NALAS, si përfaqësuese e Asociacionit të komunave të Maqedonisë në temën “Fiscal decentralization indicators in South East Europe: report 2011” gjendet në Network of Associations of Local Authorities. Shkup. Edicioni 3. 2012.
9. Ka publikuar artikullin “Equalization framework for municipalities in the Republic of Macedonia through grants” në Economic Development: Journal of the institute of economics. Vol. 1. ISSN 1409-7893. Viti 2011.

Në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorit në Universitetin e Tetovës (Buletini i Universitetit), kandidatja Dr. Shiret Elezi ka realizuar gjithsej 20 pikë nga veprimtaria shkencore-hulumtuese.

IV. VEPRIMTARIA E APLIKUAR PROFESIONALE

Kandidatja Dr. Shiret Elezi gjatë periudhës së angazhimeve në aspektin profesional, ka arritur të realizojë një sërë aktivitetesh, të cilat janë shënuar më poshtë:

- Zëvendës ministre në Ministrinë e financave, nga 22 qershor 2017 deri në 23 shtator 2020.
- Ministre në Ministrinë e pushtetit lokal, 5 prill të vitit 2016 deri 30 maj të vitit 2017.
- Udhëheqëse në Sektorin e financës në komunën e Gostivarit, 2005-2016.

Në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorit në Universitetin e Tetovës (Buletini i Universitetit), kandidatja Dr. Shiret Elezi ka realizuar gjithsej 35 pikë nga veprimtaria e aplikuar profesionale.

V. VEPRIMTARIA ME INTERES MË TË GJERË

Kandidatja Dr. Shiret Elezi, ka deklaruar se në kuadër të veprimtarive me interes të gjerë, nëpërmjet pjesëmarrjes në ngjarje dhe projekte ndërkombëtare, ka realizuar këto aktivitete:

- Projekt: “Improving Municipal Revenues”, World Bank, Budapest, Hungary, December 2011.

- International Conference: “Public and Municipal Finance in Europe and Balkans” World Bank WBI, Vienna, Austria, January 2013.
- International Conference “Local Administration Facility-Fiscal Decentralization. Evropian Commission, TAITEK, Brussels, Belgium, February 2013.
- International Conference " Gender Responsive Budgeting at Local Level. UN Women and NALAS, Istanbul, Turkey, March 2015.
- Conference on Public Internal Financial Control European Union. Skopje, November 2015.
- International Conference “Municipal Finance SEE 2020”. NALAS, Tirana, Albania, February 2016.
- EU-funded Twinning Project: Strengthening the medium term budgeting for effective public financial management" (Conference on fiscal framework and medium term budget planning), EU, Skopje 2017.
- EU-funded Twinning Project: "Strengthening the medium term budgeting for effective public financial management"(Conference on fiscal framework and medium term budget planning). 01.11.2017. Skopje.
- Developments of international tax Cooperation: Fighting tax evasion. 16-18.07.2018. Tbilisi Gruzia. OECD.
- Workshop on cash flow forecasting and cashmanagement. 17.09.2018 Ministry of Finance and WB.
- PEMPAL Internal Audit Community of practice (IACOP) Audit in Practice (AIP) Meeting. 11.04.2019. Ministry of Finance and WB.

Në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorit në Universitetin e Tetovës (Buletini i Universitetit), Komisioni recenzues konstaton se kandidatja Dr. Shiret Elezi nuk ka dorëzuar dëshmi për veprimtaritë me interes më të gjerë.

VI. FORMULARI PËR RAPORTIN PËR ZGJEDHJE NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE

Në shtojcë e bashkëngjisim formularin për raportin e zgjedhjes në thirrjen mësimore-shkencore. Kandidatja Dr. Shiret Elezi ka gjithsej 55 pikë, edhe atë për: veprimtarinë mësimore-arsimore – // pikë, veprimtarinë shkencore-hulumtuese – 20 pikë, veprimtarinë e aplikuar profesionale - 35 pikë dhe veprimtaritë me interes më të gjerë – // pikë.

REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJE	PIKËT
VEPRIMTARIA MËSIMORE-SHKENCORE	//
VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE	20
VEPRIMTARIA E APLIKUAR PROFESIONALE	35
VEPRIMTARITË ME INTERES MË TË GJERË	//
TOTALI	55

3. Kandidati Dr. Arben Halili

I. TË DHËNA BIOGRAFIKE DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL

Kandidati Dr. Arben Halili ka lindur më 10.01.1982 në Tetovë. Në vitin 2001-02 u regjistrua në Fakultetin Ekonomik në Universitetin e Tetovës, ndërsa në vitin 2005 i mbaron studimet dhe merr titullin Ekonomist i Diplomuar, drejtimi Administratë Biznesi. Pas përfundimit të studimeve universitare të ekonomisë, kandidati vazhdon studimet e Magjistraturës në Fakultetin e Ekonomisë dhe Biznesit në Universitetin e Europës Jug-Lindore në Tetovë, në drejtimin Financa. Më 24.11.2011, e mbrojti me sukses temën e magjistraturës me titull **“Ndikimi i politikës fiskale në zhvillimin e sektorit të bujqësisë në Republikën e Maqedonisë – aspekte krahasimore”** dhe morri titullin **Magjistër i financave**. Pas kryerjes së ciklit të dytë të studimeve (magjistraturës), kandidati regjistron studimet e Doktoratës në Universitetin “Kirili dhe Metodi” në Shkup. Në datë 08 qershor 2018 mbron me sukses të lartë disertacionin e doktoratës me titull **“Efektet fiskale të politikave bujqësore në Republikën e Maqedonisë”** dhe merr titullin shkencor **Doktor i Shkencave Ekonomike**.

Kandidati Dr. Arben Halili nga 17.02.2020 është angazhuar bashkëpunëtor i jashtëm në Universitetin e Tetovës. Kandidati nga viti 2014 është i angazhuar në pozitën e drejtorit gjeneral të Normak Invest Group AD Tetovo. Nga viti 2017 është po ashtu i angazhuar si drejtor organizativ në TV Klan Macedonia. Nga viti 2015 është anëtarë bordi në Odën Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore, ndërsa në periudhën 01.04.2013-10.11.2014 ka ushtruar funksionin drejtor Ekzekutiv në OEMVP.

Në eksperiencën e tij gjenden një sërë aktivitetesh që përfshijnë: angazhimin si Trajnues për Project circle management 16.12.2013-24.12.2013, në Ministrinë e Eurointegritimeve të Maqedonisë së Veriut. Oficer për monitorim dhe vlerësim të IPA projektit në Odën Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore, në periudhën 01.11.2012-05.02.2014.

Nga 01.10.2008-30.03.2013 ka qenë i angazhuar si projekt menaxher në Federatën e fermerëve të Maqedonisë. Ndërsa nga 28.03.2012-30.03.2012 ka qenë trajnues në Federatën e fermerëve të Maqedonisë.

Nga data 01.07.2007-30.09.2008 ka punuar si zhvillues tregu (market developer) në Qumështoren e Manastirit (BI Milk). Ndërsa nga data 03-05.09.2006 ka qenë trajnues në projektin SFARM.

Në dhjetor 2007 ka qenë trajnues në Federatën e fermerëve të Maqedonisë. Ndërsa në periudhën 07.12.2005-15.06.2007 ka qenë i angazhuar si këshilltar lokal për biznes në projektin SFARM.

Kandidati Dr. Arben Halili, i ka dorëzuar këto dokumente: Diplomën për fitimin e gradës shkencore Doktor i shkencave ekonomike drejtimi financa; Punimin e doktoraturës; Biografinë e shkurtër; Listën e opinioneve dhe intervistave të publikuara si dhe kopje të tyre; Vërtetim për njohje të gjuhës frënge, niveli B1; Certifikata të kurseve dhe trajnimeve; Certifikatë të nënshtetësisë dhe Certifikatë të lindjes.

II. VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE

